



MBRETNIJA SHQIPTARE
DREJTORIJA E SHKOLLËS NORMALE
E L B A S A N

Elban, më.....194.....-XX

Nr. Prot.

Shkurtimi Dërgohet pasqyra e kandidatëve maturantë për vjetin shkolluer 1942-1943.

Gjegje e shkresës Nr. 354 Res. dt. 13/V/1943.

P . T .

MINISTRIS S'ARSIMIT

T i r a n ë

Sëbashku me këtë shkresë kemi nderin t'Ju dërgojmë listën e kandidatëve maturantë të këtij Instituti, për vjetin shkolluer 1942-43, kërkuar me shkresën t'Uej të ma sipërme.

Për sa i takon gjendjes ekonomike të çdo kandidati, kjo Drejtori, për ata që ka pasë dijen, e ka shënue e, për të tjerët, vendi është lanë i hapët, mbassi nuk ka qenë e mundun me u dijtë me siguri gjendja ekonomike e tyre.

Për sjelljen, me që asnjani nuk i është zbritë gjatë vjetit, mund të thohet për të gjithë e njajtë: Shembullore.

Mbassi nuk është pamë që ndonji kandidat të ketë prirje të veçantë në ndonji lëndë mësimi, po shënohet për disa në përgjithsi përparimi vjetuer mirë ase shumë mirë.

Për prirjen që çdo kandidat mund të ketë në të mësuem në periudhën e ulët ase të naltë të shkollës fillore, u pyet Drejtorija e Ushtrimores, e cila dha shkoqitje për secilin.

Shtojmë se, për kandidatët e larguem mbrenda këtyne ditëve, nuk është dhanë asnjë shkoqitje.

Drejtori i Normales "LUIGJ GURAKUQI"

(Prof. Ibrahim Babamusta)